VENDIM
Nr. 238, datë 22.9.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "EGNATIA HYDROPOWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", dhe nenit 13, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/2 prot., datë 19.9.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Egnatia Hydropower' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 170, datë 28.6.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Egnatia Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/27 prot., datë 30.6.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.7.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Duke qenë se nga shoqëria ishte plotësuar pjesa më e madhe e dokumentacionit dhe mbetej pa u plotësuar vetëm dy sqarime lidhur me kapitalin që ortaku i vetëm vinte në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike dhe të dhëna mbi sasinë e energjisë që shoqëria parashikon të tregtojë gjatë secilit vit për 5 vjetët e ardhshëm, në zbatim të nenit 14, pika 3 e rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 10.8.2022 vendosi të shtyjë me 30 ditë punë vendimmarrjen e tij për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në mënyrë që t'i jepej mundësia shoqërisë për të plotësuar pjesën e mbetur të dokumentacionit.

- Shoqëria "Egnatia Hydropower" sh.p.k. ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e këtij aplikimi, në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Shoqëria "Egnatia Hydropower" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike në zbatim të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Egnatia Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti